

**VENDIM**  
**Nr. 182, datë 25.2.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E RREGULLUESIT KRYESOR (*LEAD MANAGER*) DHE/OSE HUADHËNËSIT PËR REALIZIMIN E HUAMARRJES ME INSTRUMENTE FINANCIARE NË TREGUN E HUAJ<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.253, datë 9.5.2018)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, shkronja “ç”, dhe paragrafi i dytë, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e *ministrit përgjegjës për financat*, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e procedurës që do të ndiqet për procesin e përzgjedhjes së rregulluesit kryesor (*Lead Manager*) dhe/ose huadhënësit dhe përmbushjen e kësaj procedure për realizimin e huamarrjes me instrumente financiare në tregun e huaj.

2. Bazuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe strategjinë e menaxhimit të borxhit publik, me propozim të *strukturës përgjegjëse për borxhin publik, në bashkëpunim me struktura të tjera të ministrisë përgjegjëse për financat, ministri përgjegjës për financat* miraton kërkesën për propozim për përzgjedhjen e rregulluesit kryesor (*Lead Manager*) dhe/ose huadhënësit dhe publikimin e saj.

3. Në kërkesën për propozim duhet të përcaktohen:

- a) qëllimi i financimit;
- b) shuma që synohet të merret hua;
- c) kriteret e përzgjedhjes në përputhje me nenin 6, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- ç) afati i paraqitjes së propozimeve;
- d) data, ora dhe vendi i paraqitjes së propozimeve;
- dh) çdo element tjetër i vlerësuar si i nevojshëm.

4. Në rast se përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të propozimeve institucionet e interesuara kërkojnë shtyrjen e këtij afati, titullari i institucionit pas shqyrtimit të kërkesës vendos pranimin ose refuzimin e saj. Vendimi për shtyrjen e afatit publikohet në faqen zyrtare të internetit të *ministrisë përgjegjëse për financat*.

5. *Ministria përgjegjëse për financat* publikon ftesën për ofertë në faqen zyrtare të internetit të *ministrisë përgjegjëse për financat* dhe në dy numra të njëpasnjëshëm në gazetën “*Financial Times*”.

6. Pas dorëzimit zyrtar në protokollin e *ministrisë përgjegjëse për financat të propozimeve nga institucionet e interesuara, struktura përgjegjëse për borxhin publik në ministrinë përgjegjëse për financat, në bashkëpunim me struktura të tjera të kësaj ministrie, fillon vlerësimin e tyre*. Afati për kryerjen e vlerësimeve është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e përfundimit të afatit për dorëzimin e propozimeve. Në varësi të analizave paraprake të propozimeve, në rast se struktura e huamarrjes e gjykon të arsyeshme, mund t’u kërkojë institucioneve financiare propozuese të dërgojnë sqarime dhe informacion shtesë duke iu caktuar dhe afatin e paraqitjes së tyre. Në këtë rast afati i vlerësimit shtyhet me 5 (pesë) ditë pune nga data e

---

<sup>1</sup> VKM nr. 182, datë 25.2.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.30, datë 4 mars 2015.  
VKM nr.253, datë 9.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, datë 17 maj 2018.

paraqitjes së sqarimeve shtesë.

7. Vlerësimi i propozimeve kryhet nga *struktura përgjegjëse për borxhin publik, në bashkëpunim me struktura të tjera të ministrisë përgjegjëse për financat* në ministri, duke u bazuar në:

a) eksperiencën e institucionit në transaksione të ngjashme, prezencën e tyre në tregje dhe kapacitetin për sigurimin e financimit të kërkuar;

b) risqet e ndryshme që mbart secili prej propozimeve;

c) koston më të ulët efektive me të gjitha elementet e saj si:

i) afati i maturimit;

ii) mënyrat e shlyerjes;

iii) komisionet, interesi dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në koston e huamarrjes në varësi të kushteve të tregut.

8. *Struktura përgjegjëse për borxhin publik, në bashkëpunim me struktura të tjera të ministrisë përgjegjëse për financat* në ministri përgatit një raport përmbledhës, ku renditen institucionet pjesëmarrëse në procedurë, të cilin ia dërgon për miratim ministrit.

9. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga paraqitja e propozimit të bërë nga *struktura përgjegjëse për borxhin publik*, vendos të miratojë ose të refuzojë shpalljen e fituesit për rregulluesin kryesor (*Lead Manager*) dhe/ose huadhënësit apo të përsëritë procedurën.

10. Shpallja e fituesit publikohet në faqen zyrtare të internetit të *ministrisë përgjegjëse për financat*.

11. Ankesat e subjekteve ndaj procedurës së zhvilluar i paraqiten, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit, ministrit i cili merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data e paraqitjes së ankesës.

12. Ministri, pas përfundimit të afatit të ankimit, negocion dhe nënshkruan letrën e mandatimit me institucionin fitues, e cila përmban, ndërmjet të tjerash, termat kryesorë të ofrimit të shërbimit.

13. Ngarkohet *ministra përgjegjëse për financat* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**